

**ROBERT GJEDIA**

**PRAKTIKA MËSIMORE EUROPIANE NË ARSIMIN SHQIPTAR  
GJATË VITEVE 1925-1939**

Është në natyrën e të vërtetave shkencore që, pavarësisht nga indiferenca apo neglizhimi ndaj tyre në kohëra të ndryshme, ato presin, por e arrijnë ditën apo çastin që të vlerësohen për të ndriçuar kohën kur ato u përvijuan, për të identifikuar potencialin intelektual që i krijoi, duke u bërë kështu të dobishme për të ardhmen, por dhe frymëzim për fillime, vazhdime e kthime të reja pedagogjike.

Në mjediset mësimore të shkollës shqiptare të viteve 1925-1939, por dhe në literaturën pedagogjike të kohës u mishëruan modele, formate dhe metodologji mësimore të sistemeve të ndryshme evropiane, të cilat mbajnë për autorë pedagogjistë të njohur botërorë që dhe në e ditët e sotme zbatohen në procesin mësimor.

**1. Bashkëpunimi me Byronë Ndërkombëtare të Edukimit (BNE)  
në Gjenevë-Zvicër dhe me institucione të tjera arsimore evropiane**

Gjatë periudhës 1927-1938 lindi dhe u zhvillua një bashkëpunim i frytshëm midis Ministrisë së Arsimit të Shqipërisë dhe Byrosë Ndërkombëtare të Edukimit në Gjenevë<sup>1</sup>.

Byroja Ndërkombëtare e Edukimit në Gjenevë ishte një organizëm me status ndërkombëtar që punonte në fushën e edukimit. Ky institucion promovonte të rejtat në edukim, sidomos elementet e pedagogjisë aktive për periudhën që flasim.

Statusi i saj ishte pranuar nga shumica e vendeve të Evropës Qendrore dhe Perëndimore, si dhe nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Konsiderohej një organizëm i vlerësuar lart profesionalisht edhe për shkak të drejtorit të tij, Zhan Piazhe, një figurë botërore e psikologjisë dhe pedagogjisë.

---

<sup>1</sup> [www.unesco.org/education/pdf/FERNIG\\_2PDF](http://www.unesco.org/education/pdf/FERNIG_2PDF). Article: The International Bureau of Education in Geneva, A Centre of the Progressive Education /New Education Movement, by Leo Fernig, October 1993.

Në ditët tona ky institucion, i quajtur IBO (International Baccalaurate Organization), funksionon si organizëm ndërshtetëror që zhvillon veprimtarinë brenda institucionit të UNESCO-s. Bashkëpunimi me Byronë Ndërkombëtare të edukimit (BNE) ishte një mundësi shumë e mirë dhe një dritare e hapur për të ndjekur nga afër zhvillimet arsimore evropiane dhe më gjerë, të cilat patën ndikim edhe në mjedisin arsimor shqiptar.

Bazuar në dokumentet e kohës lidhjet institucionale të Ministrisë së Arsimit shqiptar në këtë organizëm vendosen diku nga viti 1928<sup>2</sup>. Ka mjaft letërkëmbime të ministrave të arsimit të periudhës 1928-1935, drejtpërdrejt me Drejtorin e Byrosë Ndërkombëtare të Edukimit, Zhan Piazhe, një psikolog i njohur, i shquar në nivel botëror në fushën e psikologjisë konjitive të fëmijërisë, teoria psikologjike e të cilit studiohet në çdo universitet evropian e amerikan edhe sot.

Po ashtu kontakte me këtë organizëm mbante dhe shkolla “Normale” e Elbasanit, e cila u bë anëtare e kësaj Byroje po në vitin 1928. Vlen të përmendet kontributi i veçantë i Aleksandër Xhuvanit, i cili mbajti lidhje të vazhdueshme me këtë organizëm<sup>3</sup>.

Nga ky bashkëpunim vlen të theksojmë:

*Së pari*, ekspertizën e BNE-së për të ndihmuar në hartimin e një baze ligjore solide për arsimin shqiptar. Kështu, nga letërkëmbimet dhe materialet e dërguara gjatë vitit 1932 nga BNE-ja<sup>4</sup>, i kërkohej Ministrisë së Arsimit një raport me projektligjet e hartuara dhe më vonë institucioni u dërgonte sugjerime, rekomandime si dhe ligje të arsimit të vendeve

<sup>2</sup> Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (më tej: AQSh), Fondi (më tej: F.) 195, Viti (më tej: V.) 1928, Dosja (më tej: D.) 85, Raport i Byrosë Ndërkombëtare të Arsimit në Gjenevë, Dokumenti A 31-1928. Rregulla të njëjta për statistikat e arsimit të miratuara në Kongresin e Kajros më 1928. Broshurë me 30 faqe në frëngjisht. Ky raport i është dërguar më 1 nëntor 1928 e Ministrisë së Arsimit në Tiranë.

<sup>3</sup> *Po aty*, F. 195, V. 1928, D. 392, Raport i drejtorit të Normales së Elbasanit, Aleksandër Xhuvani, drejtuar Byrosë Ndërkombëtare të Arsimit në Gjenevë, mbi organizimin dhe zhvillimin e arsimit në Shqipëri. Ky raport dërgohet në kuadër të 100-vjetorit të Pestalocit më datë 29.07.1928 nga shkolla “Normale” e Elbasanit. Po ashtu kjo shkollë u bë dhe anëtare zyrtare e kësaj Byroje duke paguar 30 franga ari si kuotë. Ky raport është në frëngjisht dhe shqip.

<sup>4</sup> *Po aty*, F. 195, V. 1932, D. 103, fl. 2, Material në frëngjisht për ligjet e arsimit në Shqipëri përgatitur për Byronë Ndërkombëtare të Edukimit në Gjenevë.

evropiane<sup>5</sup>. Gjatë periudhës së ministrit Ivanaj u hartua një paketë e plotë ligjore dinjitoze e profesionale në fushën e shkollës shqiptare, në bazën e të cilës qëndronin edhe mjaft nga ligjet evropiane të kohës të dërguara nga BNE-ja<sup>6</sup>. Kjo përvojë e hartimit të dokumentacionit ligjor u përvijua më tej dhe me hartimin e mjaft akteve të tjera nënligjore që kanë të bëjnë me rregulloret e shkollave, rregulloret e drejtuesve të shkollës etj., materiale ligjore, që në procesin e hartimit të tyre patën ndikimin e bashkëpunimit me BNE-në.

*Së dyti*, prurjen e botimeve evropiane të kohës, përmes buletineve periodike të këtij institucioni, të cilat kishin në fokus reformimin e mësimdhënies, modele dhe formate mësimore, çështje psikologjike të trajtimit të fëmijës, si dhe mjaft tematika të ndryshme të edukimit, që gjetën përdorim në këtë periudhë në praktikën mësimore të disa institucioneve arsimore në Shqipëri<sup>7</sup>. Ato nuk ishin të përhapura dhe të përgjithësuara kudo në shkollat fillore dhe ato të mesme në Shqipëri, por u aplikuan më gjerësisht në shkollën “Normale” të Elbasanit, “Institutin “Harry Fultz”, Liceun e Korçës, si dhe në gjimnazet e Shkodrës, Tiranës dhe Gjirokastrës. Një nga çështjet më të trajtuara në buletinet e BNE-së mbetet “pedagogjia aktive” dhe format e paraqitjes së saj në klasë<sup>8</sup>. Duke u bërë pronë e institucioneve shqiptare të arsimit, këto materiale ishin një ndihmë e madhe për mësuesit dhe specialistët e shkollës. Ishte koha kur në Shqipëri do të vinin vepra të njohura të edukimit, të psikologjisë dhe pedagogjisë, si: “Psikologjia e mendërisë” e Clapardesë, “Ç’është Edukata e re” e Abel, “Lindja e të menduarit te fëmija” e Piazhesë, “Vetëveprimi është parim i lartë i të mësuarit” e Charrier dhe përkthehej Herbarti, Pestaloci, Vessiotti, Bruneri, Skinneri, Xhon Djuj, Montessori, e

---

<sup>5</sup> *Po aty*, F. 195, V. 1931. D. 317, fl. 1, Shkresë e z. Zhan Piazhë, dërguar me datë 11 maj 1932, A. Xhuvanit, në përgjigje të kërkesës të këtij të fundit për pajisje me buletine të Byrosë Ndërkombëtare.

<sup>6</sup> *Po aty*, F. 195, V. 1933. D. 1, fl. 2, Material në shqip dhe frëngjisht për gjendjen e arsimit në Shqipëri përgatitur për Byronë Ndërkombëtare të Edukimit në Gjenevë.

<sup>7</sup> *Po aty*, F. 195, V. 1931, D. 317, fl. 1, Shkresë e Zhan Piazhë, dërguar me datë 11 maj 1932, A. Xhuvanit, në përgjigje të kërkesës të këtij të fundit për pajisje me buletine të Byrosë Ndërkombëtare.

<sup>8</sup> *Po aty*, F. 195, V. 1933. D. 369, fl. 1, Shkresë e ministrit Mirash Ivanaj, e datës 02.06.1933, dërguar Zhan Piazhesë, drejtor i Byrosë Ndërkombëtare të Edukimit në Gjenevë, lidhur me pajisjen e Ministrisë së Arsimit me koleksionet e buletineve arsimore të kësaj Byroje.

mjaft teoricienë e pedagogjistë bashkëkohorë, por edhe të traditës evropiane. Kjo ishte një pasuri e çmuar që i shërbeu sistemit arsimor shqiptar. Këto vepra u studiuan thellë nga specialistë të njohur të arsimit, si: Aleksandër Xhuvani, Sotir Papahristo, Hilë Mosi, Mirash Ivanaj, Ahmet Gashi, Qamil Guranjaku, Osman Myderrizi e mjaft të tjerë.

Ishte kjo literaturë që vinte në Shqipëri nga Byroja Ndërkombëtare e Edukimit, e cila ndihmoi jo vetëm për formimin e mësuesve të rinj në shkollat normale të periudhës 1924-1939, por ndikoi në:

a) krijimin e brezit të didaktëve të parë profesionistë shqiptarë, siç është rasti i Aleksandër Xhuvanit, Sotir Papahristos, Mirash Ivanajt, Hilë Mosit etj.<sup>9</sup> të cilët, përmes veprave të tyre arritën të krijojnë gjeneratën e parë të mendimit pedagogjik shqiptar me një frymë tërësisht evropiane.

b) Shfrytëzimi i kësaj literature ndihmoi në formatimin, strukturimin dhe hartimin e revistave shqiptare të fushës së pedagogjisë, që u botuan në Shqipëri, sipas modeleve të buletineve të BNE-së<sup>10</sup>.

Buletinet e ardhura sillnin mjaft informacione që përbënin “të rejat pedagogjike” apo “të reja nga sisteme arsimore” nga e gjithë bota, si dhe lajme për veprimtaritë e ndryshme të fushës së edukimit lidhur me kongreset ndërkombëtare, konferenca, shkëmbime përvojash, vizita studimore, por dhe të dhëna nga jeta e shkencëtarëve apo psikologëve dhe didaktëve të njohur evropianë dhe botërorë, të cilat mësuesit shqiptarë i lexonin me endje<sup>11</sup>.

*Së treti*, instalimin në arsimin shqiptar të një sistemi statistikor me të dhëna të bollshme për arsimin<sup>12</sup>. Modelet dhe formatet e marra nga ky organizëm shërbyen për krijimin një sistemi statistikash të njëjtë si në të gjitha vendet evropiane, por që i shërbyen mjaft dhe të ardhmes në arsimin shqiptar. Kështu formatet e statistikave kërkonin të dhëna për nxënësit, mësuesit, drejtuesit e shkollave, për shkollat, për programet lëndore, orët mësimore etj., që ndihmuan mjaft në identifikimin dhe inspektimin e shkollave në atë kohë.

<sup>9</sup> A. Xhuvani, *Didaktika*, Elbasan: Shtëpia botuese “Elbasani”, 1937.

<sup>10</sup> “Revista Pedagogjike” filloi të botohej në vitin 1921, ndërsa revista “Normalisti” filloi të botohej më 1923.

<sup>11</sup> Rubrikë më vete tek revista *Normalisti*.

<sup>12</sup> *AQSH*, F. 195, V. 1928, D. 85, Raporti i Byrosë Ndërkombëtare të Arsimit në Gjenevë, Dokumenti A 31-1928. Rregulla të njëjta për statistikat e arsimit të miratuara në Kongresin e Kajros më 1928. Broshurë me 30 faqe në frëngjisht. Ky raport i është dërguar më 1 nëntor 1928, Ministrisë së Arsimit në Tiranë.

Pjesëmarrja e Shqipërisë në Kongresin e Kajros që u organizua nga BNE-ja me tematikë “Rregulla të njëjta për statistikat e arsimit”, si dhe miratimi i tyre në këtë kongres, më 1928, ishte fillesa e parë e hartimit, plotësimit dhe përpunimit të të dhënave sipas formateve statistikore evropiane.

Shumë tabela statistikore të identifikuar në Arkivin e Shtetit, si dhe në botime të asaj kohe janë fryt i këtij bashkëpunimi. Ky sistem statistikor ndikoi dhe krijoi një mënyrë të re pune për sektorët e Ministrisë së Arsimit, për zyrat lokale të inspektimit dhe për shkollat. Për shembull, u mundësua krijimi i regjistrit shtetëror të arsimtarëve për herë të parë në Shqipëri në vitin 1932, sipas formateve dhe kërkesave evropiane dhe kjo mund të konsiderohet një arritje për arsimin në atë kohë<sup>13</sup>.

*Së katërti*, pasurimin me një informacion të bollshëm teorik, shkencor, praktik dhe të modeluar të pedagogjisë aktive dhe elementeve të saj, që BNE-ja dërgonte në mënyrë sistematike, të cilat gjetën zbatim kryesisht në shkollën “Ushtrimore” të “Normales” së Elbasanit dhe “Ushtrimoren” e Institutit “Harry Fultz” për profilin e degës “Normale”<sup>14</sup>.

Shkolla “Normale” e Elbasanit, duke qenë anëtare e BNE-së, dhe që kishte një përgjegjësi e përkushtim për formimin e mësuesve të rinj, më mirë se askush tjetër institucion në Shqipëri, u përpoq të zhvillonte dhe të trajtonte metodikat përkatëse të lëndëve që zhvilloheshin në shkollën filllore. Këto metodika qenë rrjedhojë e bashkëpunimit të mësuesve të “Ushtrimores”, që kishin kryer studimet profesionale në shkollat pedagogjike në Evropë, me pedagogët e “Normales”. Ja pse “Ushtrimorja”, me mësues specialistë për metodika, u afirmua jo thjesht si një shkollë ku zhvillohej praktika pedagogjike, por njëherazi si një qendër e përpunimit të mendimit didaktik e zbatimit të tij në praktikë, duke pasuruar përvojën e brishtë të shkollës shqiptare me atë të shkollave të përparuara në Evropë.

Ajo që e bëri “Normalen” e Elbasanit një institucion udhëheqës të rrugës së pedagogjisë dhe të metodave mësimore, që ndikoi në përgatitjen cilësore të mësuesve por edhe në të ardhmen e pedagogjisë e të mendimit pedagogjik shqiptar ishte: shkollimi i një pjese të mësuesve të saj në shkolla evropiane; anëtarësimi në BNE; shfrytëzimi me frytshmëri i literaturës më të mirë të kohës në fushën e pedagogjisë, psikologjisë dhe

<sup>13</sup> *Po aty*, F. 195, V. 1931-1932, D. 397, Regjistri i personelit arsimor.

<sup>14</sup> “Ushtrimorja” e Shkollës “Normale” e Elbasanit u hap në vitin 1923, ndërsa ajo e Institutit “H. Fultz” në vitin 1928.

didaktikës; drejtimi profesional dhe i motivuar i kësaj shkolle nga A. Xhuvani, etj.

Në këtë kuptim kjo shkollë mund të konsiderohet si “laboratori” i parë i eksperimenteve shkencore të modeleve mësimore evropiane në mjediset e klasave, ku zhvilloheshin praktikat profesionale të mësuesve të rinj.

## **2. Bashkëpunime me institucione të tjera arsimore evropiane dhe më gjerë**

Në mjedisin arsimor profesional shqiptar, gjatë periudhës 1925-1939, ndikuan dhe bashkëpunime të tjera të cilat ndihmuan dhe nxitën më tej zhvillimet në fushën e shkollës.

Një bashkëpunim i ngushtë arsimor në këtë periudhë ishte me Italinë, e cila do të pasqyrohej edhe në median e asaj kohe, si: gazeta “The Daily Telegraf”<sup>15</sup> apo “Le Temps”<sup>16</sup>. Ndërkohë kishte dhe mjaft veprimtari arsimore që realizoheshin në bashkëpunim me institucione në Austri, Gjermani, Angli, Holandë, Belgjikë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, madje dhe me Japoninë e Indinë. Bëhej fjalë jo vetëm për studentët tanë që diplomoheshin në shumicën e universiteteve të këtyre vendeve, por edhe për shkëmbime, veprimtari kërkimore shkencore dhe pjesëmarrje në veprimtari formuese të fushës së edukimit.

Me Italinë dhe institucionet e saj shtetërore dhe private bashkëpunimet ishin të shumta, sidomos në periudhën 1929-1935 ku u mbështet sidomos zhvillimi i arsimit profesional në Shqipëri. Drejtorja Qendrore e Arsimit Profesional në Ministrinë e Arsimit në Tiranë kishte të punësuar mjaft specialistë italianë<sup>17</sup>. Lidhjet midis shkollave profesionale italiane dhe

<sup>15</sup> *AQSH*, F. 195, V. 1933, D. 287, fl. 1, Nr. 2643, datë 04.06.1933. Përmbledhje e gazetës “Le Temps” mbi problemet e sistemit arsimor italian dhe politikave italiane mbi arsimin në Shqipëri.

<sup>16</sup> *Po aty*, F. 195, V. 1928, D. 93, Material nga fletorja “La reforma” e datës 9 janar 1928. Italia dhe Shqipëria, një fjalim i mbajtur nga italianët në Lidhjen e Kombeve rreth Traktatit të Aleancës së Italisë me Shqipërinë, i cili u prit mirë dhe sfumoi e përgënjeshtroi shpifjet serbe për refugjatë politikë në Shqipëri dhe shkelje të të drejtave të tyre për arsimin. Po për këtë prezantim shkroi në këto ditë dhe gazeta e njohur “The Daily Telegraf”.

<sup>17</sup> *Po aty*, F. 195, V. 1929, D. 240-246, Programe të shkollave profesionale, teknike, industriale në italisht, si dhe listat e nxënësve dhe të mësuesve që i dërgoheshin drejtorisë së shkollave profesionale.

atyre shqiptare, mundësuan krijimin e disa llojeve shkollash profesionale në qytetet kryesore të vendit<sup>18</sup>. Një formë bashkëpunimi me Italinë ishte edhe pajisja e shkollave tona me mjete mësimore, didaktike, sportive, mbështetja për ndërtim e bazave prodhuese në shkollat tona profesionale, të cilat në shumë raste ishin dhe falas<sup>19</sup>.

Është domethënës një fakt tjetër i rëndësishëm për zhvillimin e lëndës së historisë. Në këtë periudhë realizoheshin kërkime shkencore në arkivat e Vjenës në Austri mbi historinë e Shqipërisë, gjë që tregon për një bashkëpunim midis shtetit shqiptar dhe institucioneve kërkimore të Austrisë<sup>20</sup>.

Bashkëpunimi u shtri edhe me organizma të tjerë shtetërorë dhe joshtetërorë. Është interesant fakti që një ekip me studentë shqiptarë, si<sup>21</sup>: Shefki Selenica, Perikli Mborja, Kristo Maloku, Eqrem Çabej, Odise Paskali, Stefan Shundi morën pjesë në ceremonitë në nderim të figurave të njohura të arsimit evropian, apo ftesa për pjesëmarrje në një veprimtari të organizatës “ World Association for Adults” në Londër<sup>22</sup>, si dhe pjesëmarrja në Kongresin Botëror për Arsimin në Tokio, Japoni<sup>23</sup>.

Trajnimet dhe pjesëmarrja në kurse të ndryshme të pedagogjisë dhe psikologjisë ishin pjesë e zhvillimit profesional të specialistëve të arsimit.

---

<sup>18</sup> *Po aty*, F. 195, V. 1929, D. 250, Shkresë me Nr. 354 prot për shkëmbim të programeve të shkollës industriale të Korçës dhe shkollës industriale të Gorizia-Itali.

<sup>19</sup> *Po aty*, F. 195, V. 1928, D. 168, Shkresë e firmës italiane në Milano “Luigi Apiani” drejtuar Ministrisë së Arsimit me datë 03.11.1928 për ndërtimin e një furrë buke, mekanike në një shkollë teknike në Shqipëri.

<sup>20</sup> *Po aty*, F. 195, V. 1928, D. 403, Vendimi i Këshillit të Ministrave për lirim nga detyra e inspektorit Gjergj Pekmezi, i cili emërohet kërkues i dokumenteve shqiptare në arkivat e Vjenës. Shkresë me Nr.1643/I Prot. e datës 29.10.1928.

<sup>21</sup> *Po aty*, F. 195, V. 1929, D. 632, Vendimi i Këshillit të Ministrave i datës 31.05.1929, i cili vendosi që studentët shqiptarë Shefki Selenica, Perikli Mborja, Kristo Maloku, Eqrem Çabej, Odise Paskali, Stefan Shundi të dërgohen për të marrë pjesë në ceremoninë në nder të Thompsonit që do të mbahet në Holandë, duke mbuluar dhe shpenzimet përkatëse prej 500 franga ari/secili.

<sup>22</sup> *Po aty*, F. 195, V. 1929, D. 147, Shkresë e datës 22 prill 1929. Ftesë për pjesëmarrje në Konferencën e Edukimit të të Rriturve organizuar “The World Association for Adults” 22-29 gusht 1929 në Kembrixh-Angli.

<sup>23</sup> *Po aty*, F. 195, V. 1936, D. 302, Konferenca arsimore në Tokio, Ministria e Arsimit.

Veprimtari të tilla ku kanë marrë pjesë edhe specialistë shqiptarë janë zhvilluar në Gjermani<sup>24</sup>, Itali, Zvicër Shtetet e Bashkuara të Amerikës, etj.<sup>25</sup>

Një formë tjetër e bashkëpunimit, por me vlera të veçanta, pasi shërbente për të paraqitur të dhëna, analiza dhe në përgjithësi gjendjen e arsimit në Shqipëri në Evropë, ishte dhe përgatitja e artikujve, të informacioneve dhe raporteve të specialistëve tanë për botime në institucione të ndryshme në Evropës. Për shembull, dërgimi i të dhënave të mbledhura nga nxënësit tanë të shkollave të mesme, mendimet e tyre për shkollën, për cilësinë, për pëlqimet e tyre për të studiuar jashtë, ishin të zakonshme në bashkëpunimet me Konfederatën Ndërkombëtare të Studentëve në Londër<sup>26</sup>. Kjo ishte një mundësi jo vetëm për të vjelë nga kjo organizatë pëlqimet e studentëve shqiptarë për universitetet evropiane, por që kjo të merrte dhe informacione për shkollën shqiptare në përgjithësi dhe për arritjet e saj.

Shembull tjetër është dhe bashkëpunimi i Drejtorisë së Edukatës Fizike në Belgjikë me Ministrinë e Arsimit, e cila kërkonte vazhdimisht të dhëna për edukimin fizik në Shqipëri<sup>27</sup>. Këto të dhëna janë pasqyruar në “Historikun e Evropës për Edukatën Fizike” të atyre viteve.

Pati dhe raste kur kërkohet bashkëpunimi me institucionet arsimore në Shqipëri, siç ishte kërkesa e dr. Dubash në Indi, i cili kërkonte një bashkëpunim për drejtime të ndryshme që preknin jetën artistike, kërkimet shkencore etj. Por pati edhe bashkëpunime të tjera që nuk arrinin të finalizoheshin.<sup>28</sup>

<sup>24</sup> *Po aty*, F. 195, V. 1936, D. 265, Pjesëmarrje në kurse në Akademinë e universitetit të Frankfurtit-Gjermani “Auslandsstelle”.

<sup>25</sup> *Po aty*, F. 195, V. 1927, D. 69, Njoftim i Shoqatës së Mësuesve në Shtetet e Bashkuara të Amerikës lidhur me programin dhe përmbajtjen e “Javës së Arsimit”. Ky program i është dërguar të gjitha institucioneve arsimore shqiptare në gjuhën angleze dhe shqipe, me datë 31.05.1927.

<sup>26</sup> *Po aty*, F. 195, V. 1929, D. 151, Shkresë e datës 24 tetor 1929. Konfederata Ndërkombëtare e Studentëve në Londër kërkonte informata nga studentët shqiptarë dhe dërgonte një pyetësor për ta plotësuar.

<sup>27</sup> *Po aty*, F. 195, V. 1930, D. 338, Shkresë e datës 10 shkurt 1930, e ardhur në Ministrinë e Arsimit nga Drejtoria e Edukatës fizike në Belgjikë, e cila kërkonte të dhëna për edukatën fizike në Shqipëri për t’u pasqyruar në “Historikun e Evropës për edukatën fizike”.

<sup>28</sup> *Po aty*, F. 195, V. 1929, D. 156, 3 letrat e Dr. Dubash nga India dërguar Ministrisë së Arsimit lidhur me:

Nga sa parashtruam më lart, vihet re se arsimit shqiptar në vitet 1925-1939, ishte shumë i hapur ndaj ideologjive dhe praktikave të ndryshme mësimore evropiane dhe më gjerë. Nga ana tjetër nuk mund të thuhet se ekzistonte ndonjë planifikim apo strategji e veçantë për zhvillimin e bashkëpunimeve në fushën e arsimit me vendet evropiane. Gjithsesi ekzistonte një motivim i fortë, bëheshin përpjekje maksimale, shpenzoheshin buxhete financiare dhe merrej pjesë në shumicën e veprimtarive arsimore ndërkombëtare.

Kulmi i bashkëpunimit në këtë kohë mbetet ai me Byronë Ndërkombëtare të Edukimit, e cila ishte *organizmi kryesor ndërkombëtar i promovimit të ideve të reja në arsim*. Kjo tregon largpamësi, inteligjencë dhe vokacion të fortë për të sjellë në shkollën shqiptare përvojat e vërteta profesionale evropiane.

Nga ana tjetër nuk do të mbeteshin pa u reflektuar në qëndrimet e medias evropiane ndryshimet në Shqipërinë e asaj kohe. Janë pikërisht këto bashkëpunime të larmishme, prezenca e shqiptarëve në veprimtari ndërkombëtare arsimore, të cilat bënë të mundur që gazeta e përditshme londineze “The Speaker”, e datës 22 qershor 1929, të shkruante përmes gazetares së saj të njohur në atë kohë Rosita Forbes<sup>29</sup>, se “*Shqipëria e sotme ndahet nga mënyrat e djeshme*”, “*Tirana po heq petkun oriental*”. Në këtë gazetë pasqyroheshin ndryshimet në arsim, në rrugët e Tiranës dhe një lloj civilizimi që sapo kishte nisur.

Që Shqipëria ishte në vëmendjen e medias evropiane, mund të vërtetohet lehtë dhe nga shkrimi i gazetës së përditshme në gjuhën gjermane “*Izraelitsohes Wechemblast*” në Zyrih-Zvicër e datës 27 shkurt 1930, e cila shkruante për zhvillimet që kishte marrë shteti shqiptar e në veçanti arsimit, në këto vite. Në këtë gazetë nuk lihej pa përmendur herman Bernstein i cili cilësohej “*Një gazetar i jashtëzakonshëm në Shqipëri*”. Ai ishte i sapoemëruar në Legatën amerikane në Tiranë, në

---

1- Bashkëpunimin me Lëvizjen ndërkombëtare për Vitin e Ri,

2- Bashkëpunim me aktorë dhe arte,

3- Bashkëpunimin midis të interesuarve për çështjet shkencore.

<sup>29</sup> *Po aty*, F. 195, V. 1929, D. 159, Përmbledhje e gazetës së përditshme londineze “The Speaker” e datës 22 qershor 1929, artikull i Rosita Forbes me titull: “Shqipëria e sotme ndahet nga mënyrat e djeshme” ku theksohet se “Tirana po heq petkun oriental”.

vitin 1930<sup>30</sup>. Shkrimi tregon se ai është me origjinë çifute dhe me një përvojë të mrekullueshme si gazetar në New York, sekretar i shoqatës çifute në ShBA dhe gazetar i viteve 1916 në Rusi.

### 3. Shembuj të pedagogjisë aktive në përvojat arsimore shqiptare

Në periudhën 1925-1939 në praktikat mësimore shqiptare gjejmë modele mësimore, orientuar nga pedagogjia aktive. Në filozofitë arsimore të asaj kohe, pedagogjia aktive konsiderohej nga pedagogjistët e njohur evropianë dhe amerikanë mjaft e frytshme për të nxënë.

Në mjedisin arsimor shqiptar pedagogjia aktive shfaqet përmes dy rrugëve: e para, trajtimit të saj në literaturën pedagogjike të kohës të shkruar dhe të botuar në Shqipëri; dhe e dyta përdorimit në klasë të modeleve pedagogjike të bazuara në metodat aktive.

#### 3.1. Përfaqësuesi më i denjë i botimeve që trajtojnë pedagogjinë aktive, ishte Aleksandër Xhuvani me botimin e tij “Didaktika”

Xhuvani shfaqet në shtyp në 1913 me disa shkrime në prozë në “*Kalendarin kombëtar*”. Më pas, duke filluar nga viti 1919 ai shfaqet si autor i 5 teksteve për gjuhën shqipe (1919, 1920, 1922, 1934, 1938), i një abetareje (1922), i 2 teksteve në fushën e psiko-pedagogjisë. “*Fillime të Pedagogjisë*” për shkollat normale e për mësuesit e fillores, pjesa e dytë: didaktikë e edukatë, 1926; “*Fillime të pedagogjisë*”, pjesa e parë, “*Psikologji e shtime në punë të edukatës*”, 1933 dhe i një teksti në fushën e stilistikës, me bashkautor Kostaq Cipon.

“*Didaktika*” do të shihte dritën e botimit në vitin 1937. Në përmbajtjen e saj gjenin trajtim nocione që përbëjnë risi pedagogjike për kohën dhe që u bënë shtysë për planifikime dhe zbatime të modeleve mësimore aktuale edhe për ditët tona, pasi trajtojnë me shumë profesionalizëm modelin pedagogjik të bazuar në integrimin lëndor<sup>31</sup>. Midis të tjerave aty shkruhej se

<sup>30</sup> *Po aty*, F. 195 i Ministrisë së Arsimit, V. 1930, D. 125, Përkthim i të përditshmes “*Izraelitsohes Wechemblast*” në Zyrih-Zvicër e datës 27 shkurt 1930 “*Një gazetar i jashtëzakonshëm në Shqipëri*”. Bëhet fjalë për z. Herman Bernstein, që emërohet në Legatën amerikane në Tiranë në vitin 1930. Me origjinë çifute dhe me një përvojë të mrekullueshme si gazetar në New York, sekretar i shoqatës çifute në Sh.B.A, si dhe me një karrierë si gazetar i viteve 1916 në Rusi.

<sup>31</sup> A. Xhuvani, *Didaktika* ..., f. 18.

“Mësuesit i ciklit fillor, shpesh përdornin termin “djathtësi” për të përmbledhur me një fjalë lëndët e vizatimit, punës së dorës, muzikës, edukimit qytetar, edukimit fizik etj. Është për t’u theksuar se këto lëndë kanë një peshë të konsiderueshme në programet e kohës dhe shikohen si plotësime të grupimeve të tjera lëndore. Konkretisht **“prej këtij grupi landësh të dalin fije lidhëse për landët e tjera të mësimit të cilat do t’jenë nën udhën e landës së parë”**.”

Kjo ide u përdor gjerësisht nga mësuesit për të hartuar programin vjetor apo ditor në shkollat e asaj kohe sipas parimit, *Shkolla është bërë për fëmijën dhe jo fëmija për shkollën*.<sup>32</sup> Është përparësi e shkollës, synimi për ta bërë fëmijën të aftë për jetën.

Duke shfletuar në rubrikën “mësimet provë” të revistës “Normalisti” që përmbante shkrime nga mësues, kandidatë mësues etj., rezulton se një vend të veçantë zinin mësimet provë, që kishin qenë të suksesshme gjatë zhvillimit të tyre në klasë dhe që mund të shërbenin si përvoja të mira për mësues të tjera, përfshi edhe mësuesit e rinj të *Normales* së Elbasanit-vendi ku më shumë se kudo u zbatuan dhe u aplikuan metoda aktive për të mësuarit<sup>33</sup>.

Kështu në *mësimet provë* që zhvilloheshin në klasat e ciklit fillor të shkollës “Ushtrimore” të “Normales, të pasqyruara në revistën “Normalisti” veçojmë:

Provë mësimi, klasa I, zhvilluar në shkollën “Ushtrimore” Tema: Këngë: “Melodia e vjershës “Bujku”<sup>34</sup>

1- Provë mësimi, klasa III, zhvilluar në shkollën “Ushtrimore” Tema: “Pamja e maleve të anës lindore të Elbasanit”. Lënda e punëdores, 1929<sup>35</sup>

2- Provë mësimi, klasa IV, zhvilluar në shkollën “Ushtrimore” Tema: “Njëjësi dhe shumësi i emrave”, gjuhë shqipe 1930<sup>36</sup>

3- Provë mësimi, klasa III, zhvilluar në shkollën “Ushtrimore” Tema: “Shumëzimi i numrave me numërorin 5”, 1931<sup>37</sup>.

<sup>32</sup> *Po aty*, f. 21.

<sup>33</sup> “Mësim provë” quhej mësimi i hapur-model që planifikohej nga mësuesit për zhvillimin profesional të mësuesve të rinj në praktikat pedagogjike.

<sup>34</sup> Marrë në revistën *Normalisti*, Nr. 1, qershor 1929.

<sup>35</sup> *Po aty*, maj 1929.

<sup>36</sup> *Po aty*, nëntor 1931.

<sup>37</sup> *Po aty*, mars 1931.

4- Provë mësimi, klasa III, zhvilluar në shkollën “Ushtrimore”  
Tema: “Shkallët e mbiemrit” 1931<sup>38</sup>

Nga analiza e planifikimit të mësimëve të mësipërme, vihet re se mësuesi parashikohet të luante rolin e lehtësuesit dhe nxitësit të interesit të fëmijës<sup>39</sup>, të cilat pasqyrojnë më së miri idetë e pedagogjisë aktive, të parashtruara në mënyrë teorike dhe praktike në revistën “Normalisti”, por dhe në artikuj të përkthyer nga nxënës të shkollës “Normale”. Lidhur me këtë, Aleksandër Xhuvani do të thoshte se: *...t’ja lëshojmë vendin shkollës aktive....duhet të merren parasysh psikologjia e fëmisë, nëvojat e tij dhe e drejta e tij me rrnue i lirë dhe i lumtun....”*

*ose*

*....Fëmijët nuk kuptojnë gjëra abstrakte teorike, por kuptojnë dhe duan gjëra praktike, gjëra që mund t’i shohin, t’i dëgjojnë, t’i prekin, gjëra që janë në lëvizje, me ngjyrë dhe me shumë jetë....*<sup>40</sup>

Aspekt tjetër i *mësimeve provë* ishte dhe motivimi i nxënësve që planifikohet përmes situatave nxitëse, ushtrimeve interesante për të krijuar lidhje midis njohurive të disa lëndëve etj<sup>41</sup>. Kështu nga shqyrtimi i metodologjisë së planifikuar në mësimet provë të lëndës së matematikës, identifikohen metoda aktive që nxisin të nxënësit:

- **Punën në çifte** duke bërë veprime matematikore me sende rrethanore; **punën e drejtuar** nga mësuesi, në të cilën si mësuesi dhe nxënësi punonin me të njëjtin mjet pune të përgatitur; **punën me fishat e përgatitura** nga mësuesi për grupe të caktuara nxënësish, sipas niveleve të arritjeve të tyre.

Në mësimin në natyrë që zhvillohej shpeshherë nga mësuesit në orë të veçanta të aritmetikës, parimi pedagogjik i kohës që *shkolla fillore i mësonte fëmijët për jetën*, gjente terren mjaft të përshtatshëm. Njohuritë matematikore që trajtoheshin në mësimin në natyrë kishin të bënin me matje të gjatësive të ndryshme, të perimetrit të figurave gjeometrike në forma shumë të thjeshta. Përdorëshin litarë të metrizuar, nxitej hamendësimi i fëmijëve për të gjetur saktë matjet etj. Interesant ishte

<sup>38</sup> *Po aty*, prill 1931.

<sup>39</sup> Fjala e A. Xhuvanit, mbajtur me rastin e 25-vjetorit të hapjes së Normales së Elbasanit, 1934, fl.17-18.

<sup>40</sup> A. Xhuvani, *Didaktika ...*, f. 17-18.

<sup>41</sup> Grupautorësh, *Kur arsimiti lëvronte shpirtin*, botim i organizatës “Save the Children” Tiranë: “Vini Disegnn”, 2002, f. 16-43.

planifikimi dhe zbatimi i një orë matematike në pazarin e qytetit, ku veprimet e mbledhjes dhe të zbritjes mësoheshin duke blerë fruta.

**Punën në grupe**, ndonëse kjo nuk konceptohej si tani në literaturën dhe praktikën mësimore aktuale. Në mësimin në natyrë punonin së bashku disa nxënës për të kryer matjet që ishin përcaktuar në mësim. Po kështu, **demonstrimin në çift**. Shpesh mësuesit i kryenin veprimtaritë e ndryshme gjeometrike në natyrë, duke caktuar dy fëmijë që të punonin bashkë. Në fund të mësimit çdo çift jepte rezultatet e punës rreth matjeve të bëra.

Në shumë modele mësimore të kohës apo dhe në materialet e shkruara në dokumente pedagogjike, mësuesit e arsimit fillor, **që jepnin aritmetikë**, pohonin vështirësitë që kishte kjo lëndë në realizimin e një komunikimi aktiv dhe të një procesi bashkëpunimi midis mësuesit e nxënësit, por edhe midis vetë nxënësve.

Kjo vinte si rrjedhojë e kërkesave shumë të përcaktuara të lëndës, si dhe e mungesës së përvojës në trajtimin ndërveprues të koncepteve matematikore, ndonëse në lëndët e tjera, po të njëjtët mësues kishin realizuar mësim shembullor për organizimin bashkëpunues. Në këto mësim të gjithë fëmijët ndërvepronin së bashku, flisnin, shkruanin, lexonin në grupe të mëdha dhe individualisht këndonin, vizatojnë dhe mësuesi i drejtonte ata në këtë proces.

Zhvillimi i orës tradicionale të aritmetikës ndiqte këtë ecuri<sup>42</sup>:

- Mësuesi kontrollon detyrat e shtëpisë;
- Mësuesi i drejton klasës një sërë pyetjesh që kërkojnë përgjigje të shkurtra;
- Mësuesi ngre një deri dy nxënës në tabelën e zezë;
- Mësuesi shpjegon temën e re;
- Mësuesi bën një përmbledhje;
- Mësuesi cakton detyrat e shtëpisë.

Nr.	Elementet e strukturës së mësimit dhe pjesëmarrësit në të	Përcaktimi
	Kohëzgjatja	Rigorozisht e përcaktuar
	Tema	Rigorozisht e përcaktuar
	Përmbajtja	E caktuar kryesisht nga mësuesi dhe teksti
	Mësuesi	Absolut
	Nxënësi	Dëgjues

<sup>42</sup> Po aty.

Një vend të rëndësishëm në “mësimet provë” zinte planifikimi dhe zbatimi i lëndës së **gjuhës shqipe** në orët mësimore. Mësuesit e shkollës “Normale” të Elbasanit hodhën themelet e para të metodologjisë së mësimin të gjuhës shqipe.

Në orët mësimore të gjuhës shqipe përvijohet një metodologji që kishte në vetvete një strukturë të tillë: **Pjesa e parë: hyrja e mësimin**, në të cilën përdoren metoda dhe teknika stimuluese, si të pyeturit ose ushtrime që kërkojnë përcaktime dhe emërtime të ndryshme. **Pjesa e dytë** që ka të bëjë me të kuptuarit e konceptit; zhvillohen ushtrime, sqarime të rasteve e të ndryshme, zbatime të rregullave gjuhësore në ushtrime etj. **Pjesa e tretë dhe e fundit**, ku zhvillohen përsëritje, prezantime, qortime dhe vlerësime të punëve të kryera, si dhe dhënia e detyrave të shtëpisë.

Kjo strukturë mësimore tripjesëshe është modeli i parë didaktik i krijuar nga mësuesit e “Normales”, i cili ka dhënë një kontribut të vlefshëm për mësimin e gjuhës shqipe sipas ideve të pedagogjisë aktive.

### 3.2. Mësimi i gjuhëve të huaja<sup>43</sup>

Mësimi i gjuhëve të huaja ishte i detyrueshëm në shkollat fillore dhe të mesme në Shqipëri<sup>44</sup>. Përpara fillimit të funksionimit të *Normales*, në shkollat e tjera mësoheshin kryesisht gjuhët klasike, si: latinishtja e greqishtja e vjetër. Mësimi i tyre lidhej me ndikimet e kulturave udhëheqëse fetare, por dhe ngaqë mësuesit për gjuhët evropiane, mungonin. Shumë mësues njihnin vetëm gjuhët greke, turke, arabe. Gjithashtu ndikonte edhe përdorimi i gjuhëve të popujve fqinjë për komunikim e shkëmbime me ta.

<sup>43</sup> *AQSH*, F. 195, V. 1924, D. 25, Letër e Inspektorit të Parë, Sotir Papahristo në Korçë, dërguar Ministrisë së Arsimit më 17.01.1924 ku i kërkohet heqja e mësimin të gjuhës frënge në klasat e para të fillores. Në këtë letër shpjegohet se ishte e pamundur që kjo gjuhë të mësohej në klasat e para dhe të dyta të arsimit fillor, duke pasqyruar vështirësitë didaktike, pedagogjike dhe shëndetësore që ndikojnë në zhvillimin e fëmijës.

<sup>44</sup> *Po aty*, F. 195, V. 1933, D. 225, Relacion i Ministrisë së Arsimit ku thuhet se gjuha italiane bëhej e detyruar në shkollat e mesme dhe në të gjitha shkollat fillore do të mësohej si gjuhë e huaj; *Po aty*, F. 195, V. 1935, D. 295; *Fletorja zyrtare*, Nr. 52, datë 11.09.1933. Rregullore për mësimin e gjuhëve të huaja në shkollat e mesme, dekretuar me datë 26.08.1933.

Në periudhën 1925-1939 gjuhët e huaja më të mësuara në Shqipëri ishin: italishtja, frëngjishtja dhe gjermanishtja<sup>45</sup>. Gjuha frënge mori përparësi për të ndjekur liceun francez në Korçë, si kundërvënie ndaj gjuhës greke në shkollat greke. Gjuha italiane u përdor në shumë shkolla profesionale dhe në të gjitha shkollat “Normale”.

Shkolla “Normale” e Elbasanit, duke qenë e para në llojin e saj në Shqipëri, shënon fillimin e mendimit dhe të përvojës didaktike shqiptare për gjuhët e huaja. Gjuha e huaj nuk ishte më mjet për të mësuar lëndët e tjera, por gjuhë e huaj përballë shqipes. Në shkollat e mesme ajo konsiderohej lëndë kryesore krahas gjuhës shqipe, matematikës, filozofisë etj.

Mësimi i gjuhës së huaj kishte si qëllim përdorimin e saj gjatë gjithë jetës. Karakteristika kryesore e metodës së mësimin të gjuhës së huaj mishërohej në faktin se gramatika ishte jo vetëm mjeti, por edhe qëllimi i të mësuarit të saj. Kjo është arsyeja që edhe tekstet mësimore të gjuhëve të huaja sipas kësaj metode konceptoheshin kryesisht si tekste gramatike, nga mësuesit francezë të Liceut të Korçës dhe nga mësuesit italianë që kontribuonin në shkollën “Normale” të Elbasanit. Me futjen në shkollë të gjuhës së huaj, jo si gjuhë e mësimdhënies, ndryshoi edhe metodologjia.

Në këtë kohë duken përpjekjet e para për futjen e metodës aktive, krahas mbizotërimit të metodës tradicionale gramatikore që mbështetej në mësimin e gjuhës shqipe.

Një vend të veçantë në artikujt e revistës “Normalisti” zënë dhe shkrimet për pedagogjinë aktive nga autorë të ndryshëm që citojnë, përkthejnë dhe përshtatin elemente të ndryshme të pedagogjisë aktive në përvojën shqiptare të mësimdhënies.

Sotir Papahristo, një personalitet arsimor me shumë vlera dhe me kontribute në arsimin shqiptar të periudhës 1920-1939, si mësues, drejtues shkolle, inspektor, specialist në Ministrinë e Arsimit, drejtor i Drejtorisë së Parë Qendrore të Arsimit në Tiranë, që më vonë u kthye në Ministri Arsimit, si dhe më pas në detyra dhe poste shtetërore, në shkrimet e tij në revistën “Normalisti” trajtoi elemente të pedagogjisë aktive.

Pohimet e mëposhtme janë tregues i qartë i motivit të tij, të fortë, profesional për metodat e pedagogjisë aktive:

---

<sup>45</sup> AQSH, F. 195, V. 1933, D. 1, fl. 2, Material në shqip dhe frëngjisht për gjendjen e arsimit në Shqipëri përgatitur për Byronë Ndërkombëtare të Edukimit në Gjenevë.

*“Një të mësuar pasiv nuk zhvillon pavarësi mendjeje as vetveprim. Nxënësit e sotshëm kanë frikë të shfaqin mendimin e tyre lirisht, nuk kanë inisiativë. Aktiviteti fitohet vetëm me anë të vetveprimit, vetëm me zbatimin e njohurive”.*<sup>46</sup>

*“Në një klasë të mbaruar (të përkryer), duhen vetëm aktorë dhe jo spektatorë, cilido duhet të lozë rolin e tij”.*<sup>47</sup>

*“Fëmija ka brenda vehtes shumë zotësi, që të krijojë, të fantazojë, të ndryshojë...Këto cilësi duhet ti'a drejtojmë e zhvillojmë...  
.....Nevoja e fëmijës është veprimi i tij, ai gjen kënaqësi e interes, atje ku ka gjallësi, aktivitet, emocion....”*<sup>48</sup>

*“Qëllimi i shkollës së re nuk është me përgatit nxënësin për jetën, por me e ba atë të rrojë. Shkolla është jetë.T'i afrohem parimit të Spenserit (me mësue sa më pak që të jetë e mundur, me ba me gjetë sa më shumë të jetë e mundur)”.*<sup>49</sup>

*“Shkolla çmon që një qenie njerëzore nuk mund të formohet së jashtmi, por për së brendshmi, pa mohuar faktin se në punë të arsimimit dhe të njohurive ka një farë mekaniciteti. Shkolla nuk ndreq, por rrit. A nuk mund ta bëjë këtë më mirë se kush tjetër, vecse metoda liberale?”*<sup>50</sup>

*Metoda e përdorur e bën mësimin të këndshëm dhe interesant.Në këtë mënyrë i është shpëtuar atij mëkati për të cilin Herbart-i do të shprehej:  
“Me qënë i mërztshëm është mëkati më i madh i mësimit”*<sup>51</sup>.

<sup>46</sup> “Provë mësimi”, *Normalisti*, nr. 1, nëntor 1936.

<sup>47</sup> *Normalisti*, Nr. 1, janar 1937. Paparisto këtu i referohej A. Vessiot.

<sup>48</sup> *Po aty*, Nr. 1, maj 1933.

<sup>49</sup> *Po aty*, Nr. 1, shkurt 1934.

<sup>50</sup> *Po aty*, Nr. 1, qershor 1936 dhe S. Papahristo “Filozofia e shkollës fillore” në *Normalisti*, viti 1936, nr.1.

<sup>51</sup> *Po aty*, Nr. 1, tetor 1935, fl.8.

*S u m m a r y*THE INTRODUCTION OF THE EUROPEAN MODEL IN THE ALBANIAN  
EDUCATIONAL SYSTEM  
(1925-1939)

The developments in education from 1925-1939 are of crucial importance in the history of the Albanian education, for the strengthening of its institutions and the establishment of the educational legal framework on the example of the regional and broader models. In the teaching practice were introduced models, patterns and methods taken from different western systems designed by prominent figures of the world's pedagogy. The Albanian education system implemented different European methodologies and practices and at the same time established institutional relations with international forums such as the International Bureau of Education in Geneva (Switzerland) in 1927 and also with other similar institutions in Italy, Austria, Germany, England, the USA, etc. The most accepted and widespread method was that of 'active' teaching, which in Albania was best represented by the publication of A.Xhuvani "Didactics". This book dealt with the most recent pedagogical ideals of the time that would soon be introduced in the Albanian teaching practices and would lay the basis of the today's educational system in the country.

